



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 38 (827736)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 17 Shtator 2021

Përkujtohen viktimat e sulmeve të 11 Shtatorit



Peleshi: Lufta nuk ka mbaruar, terrorizmi mbetet armik i pabesë

Gati 3000 viktimat e shkaktuara nga sulmet terroriste të 11 Shtatorit u përkujtuan në një ceremoni në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë. Në këtë ceremoni soleme morën pjesë edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj. Në emër të qeverisë shqiptare, min-

istri Peleshi kujtoi viktimat e pafajshme të atyre sulmeve dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes aleatëve për të luftuar terrorizmin. Ministri Peleshi përmendi me krenari kontributin e Shqipërisë në këtë luftë me në krye SHBA-të dhe falënderoi gratë dhe burrat që shërbyen me kurajë në... >>> faqe 2

Smaçi: Jemi në fazën më të mirë të transformimit të arsimit ushtarak në veçanti në nivel universitar

Intervistë me Dr. Etleva Smaçi, zëvendës dekanë e Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë



>>> faqe 6-7

Konferenca e Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Ballkanit Ministri Peleshi: Hartimi i një Programi për Sigurinë Rajonale, do të forconte bashkëpunimin dhe efikasitetin gjatë krizave në rajon

Konferenca formati "Graz" ka për qëllim zbatimin e Strategjisë së BE-së për Ballkanin Perëndimor në drejtim të qëndrueshmërisë, stabilizimit të rajonit dhe pro-anëtarësimit në Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP) >>> faqe 3



Takimi

SHSHP të FARSH, priti në takim zëvendëskomandantin e Forcave Tokësore të SHBA-së për Evropën dhe Afrikën (USAREUR)

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim zëvendëskomandantin e Forcave Tokësore të SHBA-së për Evropën dhe Afrikën (USAREUR-AF), gjeneralmajor Joseph F. Jarrard, Gjeneralmajor Begaj në fjalën e rastit theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ushtarak që ekziston midis Shqipërisë dhe SHBA-së, duke vlerësuar kontributin e vazhdueshëm...



>>> faqe 4

Misioni

Hatixhe Çollaku, komandatja e parë e Inteligjencës së Gardës Kombëtare të "New Jersey" në Shqipëri

Togerja Hatixhe Çollaku u largua nga Shqipëria me familjen, drejt Shteteve të Bashkuara, kur ishte vetëm shtatë vjeç. Tani, ajo kthehet në Shqipëri si komandantja e parë në Kompaninë e Inteligjencës të Gardës Kombëtare të New Jersey-it, së bashku me kolegët e saj, për të trajnuar Forcat e Armatosura Shqiptare mbi përdorimin e sistemeve ajrore pa pilot PUMA, dhuruar nga Shtetet e Bashkuara. Kur u largua nga Shqipëria, vështirë... >>> faqe 5



NATO përkujtoi njëzet vjetorin e sulmeve të 11 shtatorit

Stoltenberg: "Ne duhet të vazhdojmë të qëndrojmë së bashku"

>>> faqe 8

KURSI I LARTË I SIGURISË SË MBROJTJES

Shembulli më i mirë për ta reformuar dhe ndërkombëtarizuar AFA sipas modelit West Point >>> faqe 2

HISTORI

Nikoll Kota, patrioti që luftoi për çlirim kombëtar >>> faqe 14

Gati 3000 viktimat e shkaktuara nga sulmet terroriste të 11 Shtatorit u përkujtuan në një ceremoni në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë. Në këtë ceremoni solemne morën pjesë edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj. Në emër të qeverisë shqiptare, ministri Peleshi kujtoi viktimat e pafajshme të atyre sulmeve dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes aleatëve për të luftuar terrorizmin. Ministri Peleshi përmendi me krenari kontributin e Shqipërisë në këtë luftë me në krye SHBA-të dhe falënderoi gratë dhe burrat që shërbyen me kurajë në Afganistan dhe Irak. “Në këto 20 vite, së bashku, të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, marshuam në zemër të terrorit për të mbrojtur vlerat thelbësore të lirisë dhe dinjitetit njerëzor. Unë besoj se edhe Shqipëria i mbajti mbi shpatulla me dinjitet këto 20 vite luftime të përbashkët.

Dua të shpreh mirënjohje dhe nderim të thellë për të gjithë ata burra dhe gra, ushtarakë profesionistë, që nderuan vendin e tyre në misionet më të rrezikshme në Irak dhe Afganistan”.

Duke iu referuar ngjarjeve të fundit në Afganistan, ministri Peleshi theksoi rëndësinë e vijimit të bashkëpunimit mes aleatëve për të fituar një luftë që ende s’ka përfunduar dhe siguroi SHBA-të se Shqipëria do të jetë krah aleatëve për çdo vendim që do të merret për të parandaluar sulme të tjera të tmerrshme. “Lufta jonë e përbashkët ende nuk ka mbaruar! Do të donim që me ikjen tonë të linim pas një Afganistan të qetë e demokratik, ku jeta, liria dhe dinjiteti i popullsisë civile të mbrohet dhe garantohej. Terrorizmi mbetet një armik i egër dhe i pabesë. Detyra jonë është të mbetemi të bashkuar, të ndajmë informacionin, të ndërveprojmë në çdo qelizë për të shmangur rreziqet që vijnë nga befasia. Ne mirëpritëm dhe mirëpresim me bujari këdo që na kërkon ndihmë dhe strehë. Civilët e pafajshëm të Afganistanit janë në besën tonë, sa kohë që atyre u duhet mbrojtje. Siguroj SHBA-të dhe vendet e tjera aleate se, në çdo kohë, në çdo vendim që merret për të garantuar jetën dhe lirinë e qytetarëve tanë, ne do të jemi gati e përkrah tyre për të parandaluar një tjetër 11 shtator.” - u shpreh ministri Peleshi.

Në fjalën e tij, zëvendës ambasadori i SHBA-së, Demian Smith, veç viktimave amerikane, kujtoi dhe ata me origjinë nga Shqipëria. Në sulmet e 11 Shtatorit të vitit 2001 në SHBA mbetën të vdekur 2977 qytetarë të pafajshëm dhe u plagosën më shumë se 6000 të tjerë.



Në këto 20 vite, së bashku, të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, marshuam në zemër të terrorit për të mbrojtur vlerat thelbësore të lirisë dhe dinjitetit njerëzor. Unë besoj se edhe Shqipëria i mbajti mbi shpatulla me dinjitet këto 20 vite luftime të përbashkët.

PËRKUJTOHEN VIKTIMAT E SULMEVE TË 11 SHTATORIT

Peleshi: Lufta nuk ka mbaruar, terrorizmi mbetet armik i pabesë



Në Akademinë e FA-së nisi programi më i lartë i piramidës së arsimit ushtarak, Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Pjesëmarrës në të do të jenë ushtarakë të lartë përfaqësues nga vende si: Shqipëria, Gjermania, Italia, Bullgaria, Gjeorgjia, Greqia dhe Republika e Kosovës.

Ky kurs i cili prej vitësh ka ofruar cilësi të lartë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, vazhdon të jetë shembull në ambicien e tij për të reformuar dhe ndërkombëtarizuar AFA-në sipas modelit West Point, për ta shndërruar në qendrën e edukimit ushtarak në rajon.

NIS KURSI I LARTË I SIGURISË DHE MBROJTJES 2021-2022

Shembulli më i mirë për ta reformuar dhe ndërkombëtarizuar AFA sipas modelit West Point



STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**
Hajrie **DEDAJ**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"



Ministri i Mbrojtjes, zoti Niko Peleshi, ndër të tjera vuri në dukje rëndësinë që ka për çdo iniciativë rajonale "Politika e Dyerve të Hapura" për të gjitha vendet e rajonit. Përfshirja e Kosovës dhe të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor mbetet parimi themelor ku mbështet zhvillimi rajonal në të gjitha fushat.

Konferenca e Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Ballkanit

Ministri Peleshi: Hartimi i një Programi për Sigurinë Rajonale, do të forconte ndjeshëm bashkëpunimin dhe efikasitetin gjatë krizave në rajon

Me iniciativë të Ministrisë së Mbrojtjes së Austrisë u zhvillua në Krems të Austrisë Konferenca e Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Ballkanit Perëndimor, format "Graz".

Me ftesë të palës austriake, në takim morën pjesë ministrat e Mbrojtjes dhe përfaqësues të nivelit të lartë të Austrisë, Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë. Delegacioni shqiptar kryesohej nga ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi.

Konferenca ka për qëllim zbatimin e Strategjisë së BE-së për Ballkanin Perëndimor në drejtim të qëndrueshmërisë, stabilizimit të rajonit dhe pre-anëtarësimit në Politikën e Përbashkëta të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP). Pjesëmarrësit u njohën mbi inovacionet më të fundit të CSDP nga përfaqësues të nivelit të lartë të Komisionit Evropian.

Gjatë takimit u shkëmbyen mendime mbi politikën e Mbrojtjes, për të promovuar bashkëpunimin rajonal në formën e programeve dhe aktiviteteve, me qëllim rritjen e ndërveprimit rajonal për Operacionet e Mbështetjes së Paqes (PSO) të drejtuara nga BE, operacionet ndërkufitare të menaxhimit të fatkeqësive natyrore dhe transmetimin e vlerave ushtarake/kulturore të Evropës Perëndimore, për të promovuar rritjen e stabilitetit dhe besimit reciprok në rajon. Ministri i Mbrojtjes, zoti Niko Peleshi, ndër të tjera vuri në dukje rëndësinë që ka për çdo iniciativë rajonale "Politika e Dyerve të Hapura" për të gjitha vendet e rajonit. Përfshirja e Kosovës dhe të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor mbetet parimi themelor ku mbështet zhvillimi rajonal në të gjitha fushat.

Në fjalën e tij të rastit, ministri Peleshi falënderoi vendet pjesëmarrëse që pranuan këmbënguljen e Shqipërisë për aplikimin e Politikës së Dyerve të Hapura, çka i jep mundësi çdo shteti të bëhet pjesë e kësaj konference. Emergjencat gjatë viteve të fundit kanë

Konferenca formati "Graz" ka për qëllim zbatimin e Strategjisë së BE-së për Ballkanin Perëndimor në drejtim të qëndrueshmërisë, stabilizimit të rajonit dhe pro-anëtarësimit në Politikën e Përbashkëta të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP)

shfaqur solidaritetin e vendeve mes njëri-tjetrit, por ende ka vend për përmirësim. Hartimi i një Programi për Sigurinë Rajonale, do të forconte ndjeshëm bashkëpunimin dhe efikasitetin gjatë krizave në rajon, theksoi ministri Peleshi.

Në përfundim të takimit u nënshk-

rua Deklarata e Përbashkët me të cilën synohet rritja e bashkëpunimit rajonal në fushat e "Dialogut Strategjik" dhe "Ndërtimit të Kapaciteteve". Gjithashtu u ra dakord se të gjitha vendet pjesëmarrëse mbeten të angazhuara për një "Politikë të Dyerve të Hapura",

duke mirëpritur çdo vend i cili ndan të njëjtat parime dhe kontribuon në sigurinë rajonale. Gjatë kësaj konference, ministri Peleshi zhvilloi takime të shkurtra informale me homologët e tij nga Austria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bosnje-Hercegovina dhe Serbia.

Gjatë këtyre ndërveprimeve informale, z. Peleshi nënvizoi qëndrimin konstruktiv të Shqipërisë në rajon për sa i përket proceseve integruese dhe gatishmërinë për të vijuar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, si dhe shqyrtuar mundësi të reja në të ardhmen.



SHSHP të FARSH, priti në takim zëvendëskomandantin e Forcave Tokësore të SHBA-së për Evropën dhe Afrikën (USAREUR)

"Bashkëpunimi midis trupave amerikane dhe shqiptare do të vijojë edhe përtej stërvitjes së zhvilluar këtë vit 'Defender 21'"

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim zëvendëskomandantin e Forcave Tokësore të SHBA-së për Evropën dhe Afrikën (USAREUR-AF), gjeneralmajor Joseph F. Jarrard,

Gjeneralmajor Begaj në fjalën e rastit theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ushtarak që ekziston midis Shqipërisë dhe SHBA-së, duke vlerësuar kontributin e vazhdueshëm që ushtria amerikane ka dhënë dhe vazhdon të japë në rritjen e aftësive operacionale të FARSH.

Njëkohësisht, një falënderim të veçantë gjeneralmajor Begaj adresoi për Zyrën e Bashkëpunimit të SHBA-së në fushën e Mbrojtjes të atashuar në Shqipëri, duke vlerësuar punën dhe kontributin e vazhdueshëm që ata vijnë të japin në këtë drejtim.

Gjeneralmajor Jarrard nga ana e tij, pasi vlerësoi angazhimin maksimalisht dhe performancën e treguar nga FARSH në të gjitha kontributet ndër vite, si pjesë e misionit ISAF dhe më vonë Resolute Support, në Afganistan, theksoi se SHBA-të qëndrojnë pranë aleatëve dhe partnerëve të tyre siç kanë qëndruar edhe pranë Shqipërisë, me synim ndërtimin e marrëdhënieve të forta dhe promovimit të ndërveprimit ushtarak dhe ngritjen e kapaciteteve.

Në fund, ai siguroi gjeneralmajorin Begaj se bashkëpunimi midis trupave amerikanë dhe shqiptarë do të vijojë edhe përtej stërvitjes së zhvilluar këtë vit "Defender 21", e fokusuar në fushat e trajnimit dhe shkëmbimit të eksperiencës.

Gjatë këtij takimi, nga ana e komandantit të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), gjeneral brigade Albert Mullai, u mbajt një brifing informues me tematikë rolin që ka AFA në arsimimin, trajnimin dhe edukimin e personelit të FARSH, njëkohësisht edhe mbi vizionin e ardhshëm të AFA-së. Ushtria Amerikane për Evropën dhe Afrikën siguron forca tokësore të gatshme për të penguar, dhe nëse është e nevojshme, për të mposhtur çdo agresion nga kundërshtarë të mundshëm në Evropë dhe Afrikë. Për ta arritur këtë, USAREUR-AF vendos kushtet e nevojshme dhe është e përgatitur të shërbejë si Shtab i Forcave të Përbashkëta, për të luftuar në të gjithë spektrin e plotë të operacioneve ushtarake, nga reagimi ndaj emergjencave apo krizave, dhe deri në luftime në shkallë të gjerë.



Zëvendëskomandanti i Ushtrisë Amerikane për Evropën dhe Afrikën, vizitë zyrtare në Forcën Tokësore

Gjeneralmajor Joseph Jarrard: Bashkëpunimi ka për synim rritjen e aftësive dhe gatishmërisë operacionale të Forcës Tokësore

Komandanti i Forcës Tokësore, Gjeneral Brigade Arben Kingji priti në takim zyrtar zëvendëskomandantin e Ushtrisë Amerikane për Evropën dhe Afrikën, gjeneralmajorin Joseph Jarrard. Në takimin e zhvilluar, komandanti i Forcës Tokësore shprehu falënderimet për ndihmën dhe asistencën amerikane në zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta mbi pajisjet e reja të marra dhe stërvitjeve me njësitë e kësaj force.

Eksperiencia e përfituar nga ky bashkëpunim ka ndihmuar në rritjen e ndërveprueshmërisë së efektivëve tanë gjatë zhvillimit të stërvitjeve dhe misionëve të përbashkëta, duke përfituar ekspertizën më të mirë të trupave ushtarake amerikane.

Gjeneralmajor Jarrard vlerësoi angazhimin dhe performancën e treguar nga Forca Tokësore gjatë stërvitjes "Defender Europe - 21", e cila kishte peshën më të madhe të angazhimit me trupa dhe mjete, si dhe theksoi që bashkëpunimi ka për synim rritjen e aftësive dhe gatishmërisë operacionale



të Forcës Tokësore.

Forca Tokësore në bashkëpunim me USAREUR-AF, për vitin 2022 do të zhvillojë disa stërvitje të rëndësishme si: "Swift Response", "Saber Junction", "Laufer", në kuadër të

stërvitjes "Defender Europe", si dhe stërvitjet e tjera të përvitshme si JCET, KFOR etj. Nga pala shqiptare, në takim morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, shefi i Shtabit në

Forcën Tokësore kolonel Ilirjan Dauti, komandanti i ROS kolonel Arben Zani, komandanti i b2k nënkolonel Dritan Muka.

Takimi u mbyll me shkëmbim dhuratash dhe një foto të përbashkët.

Vajzat Shqiptare, histori sukcesi

Hatixhe Çollaku, komandatja e parë e Inteligjencës së Gardës Kombëtare të "New Jersey" në Shqipëri

Togerja Hatixhe Çollaku u largua nga Shqipëria me familjen, drejt Shteteve të Bashkuara, kur ishte vetëm shtatë vjeç. Tani, ajo kthehet në Shqipëri si komandatja e parë në Kompaninë e Inteligjencës të Gardës Kombëtare të New Jersey-it, së bashku me kolegët e saj, për të trajnuar Forcat e Armatosura Shqiptare mbi përdorimin e sistemeve ajrore pa pilot PUMA, dhuruar nga Shtetet e Bashkuara. Kur u largua nga Shqipëria, vështirë të mendonte rikthimin në vendlindjen e saj, për më tepër si ushtarake. E graduara Togere e Parë, Hatixhe Çollaku është Komandante e Kompanisë së Inteligjencës të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit. "Jam larguar nga Shqipëria në moshën 7-vjeç. Arsimin, nga klasa e parë deri në universitet, e kam kryer komplet në Amerikë", -thotë ajo. Togere e Parë Çollaku ndodhet në Shqipëri me mision trajnimit të Forcave të Armatosura për përdorimin e dronëve të dhuruar nga Shtetet e Bashkuara.

"Kam ardhur për një mision: të mësojmë përdorimin e "UAV"-ve për ushtrinë shqiptare. "UAV" është një dron për misione taktike, civile, në situata emergjencash dhe humanitare", -regon Togere Çollaku. Hatixheja thekson se, duke kërkuar mundësi për rritje në karrierën e saj, me takime dhe biseda me njerëz të ushtrisë, mësoi që kërkohej një oficer inteligjence për Shqipërinë.

"Kur e morën vesh që jo vetëm jam oficer, por flas edhe shqip, u gëzuan shumë dhe thanë: "me siguri do të jesh ti pjesë e këtij misioni". Kur erdha ka qenë shumë eksperiencë e bukur të shoh, jo vetëm rreshterët, por edhe oficerët që mundohen të marrin trajnim nga ushtria amerikane për të avancuar kapacitetet e tyre". Hatixhe Çollaku thotë se ka dashur kurdoherë të kthehej në Shqipëri me mision, prandaj hyri në Gardën e Nju Xhersit, duke qenë Komandatja e parë femër e Kompanisë së Inteligjencës. "Ngaqë jam rritur në Amerikë, ndihem të dyja", por jam shumë krenare që jam shqiptare! T'ua tregoj historinë e Shqipërisë, si është kultura shqiptare, si janë njerëzit, çfarë do të presësh kur të arrish në Shqipëri", -shprehet ajo. Hatixhe Çollaku vjen nga një familje e lidhur me ushtrinë, pasi babai i saj ka qenë major i logjistikës në ushtrinë e Shqipërisë. Jam larguar nga Shqipëria në moshën 7-vjeç. Para shumë vitesh kam pasur hallë që jetonte përballë shkollës ku bëheshin stërvitje dhe thosha gjithmonë: a do jemi unë ndonjëherë në anën e kundërt. Kam parë shumë sakrificë që kanë bërë prindërit e mi kur kemi ikur në Amerikë, dhe duke parë ato sakrificë dhe duke pasur atë ndjenjë që të jem si prindërit e mi, të fortë dhe të mundohem të arrij sa më shumë jam futur në ushtrinë amerikane. Jam shumë krenare që jam shqiptare dhe gjej mundësinë që t'ua tregoj në Amerikë historinë e Shqipërisë", -regon Çollaku.



CEREMONIA ME RASTIN E LIRIMIT NGA FA TË PERSONELIT TË FORCËS DETARE

Komandanti Ilir Xhebexhia vlerësoi punën dhe kontributin e kapitenit të Rangut I Subi Zenelaj, major Hilmi Mema dhe kryekapter Naim Lika

Në Komandën e Forcës Detare u zhvillua ceremonia e përcjelljes së disa ushtarakeve të cilët e mbyllën me sukses karrierën nën uniformë.

Komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, vlerësoi punën dhe kontributin e kapitenit të Rangut I Subi Zenelaj, major Hilmi Mema dhe kryekapter Naim Lika, në Forcën Detare.

Në vijim të ceremonisë, kapitenit të Rangut I Subi Zenelaj, iu dorëzua "Certifikata e Mirënjohjes", akorduar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneral-major prof. asoc. Bajram Begaj, për kontributin e lartë në të gjitha detyrat që ka shërbyer në Forcën Detare. Duke filluar nga viti 1986, ka shërbyer në FA si komandant Katër Silurues dhe ka vazhduar në detyra të larta si, komandant i Flotiljes Detare Pashaliman, shef Shtabi i Forcës Detare, zëvendës-komandant i Forcës Detare dhe



duke e mbyllur karrierën me sukses si komandant/kordinator në QNOD.

Gjithashtu, gjeneral brigade Ilir

Xhebexhia, vlerësoi me "Certifikatë Mirënjohje", major Ilmi Mema dhe kryekapter Naim Lika duke i falë-

deruar për kontributin dhe përkushtimin e dhënë gjatë viteve që kanë shërbyer në Forcën Detare.

Akademia Ushtarake

Smaçi: Jemi në fazën më të mirë të transformimit të arsimit ushtarak në veçanti në nivel universitar

ANJEZA MUSOLLARI

Znj. Smaçi, arsimimi ushtarak në Shqipëri është një shtyllë e rëndësishme në edukimin kombëtar. Që nga shkolla e parë, e cila u hap për nevojat e organizimit dhe drejtimit të xhandarmërisë shqiptare, më 1919 dhe deri në ditët e sotme arsimit ushtarak ka shërbyer si një gjenerator për përgatitjen e kuadrit ushtarak. Akademia Ushtarake si Institucion i Arsimit të Lartë e ka zanafillën që në vitin 1957, kur u themelua edhe Universiteti i Tiranës. Në rrugëtimin e tij, ky institucion arsimor ka njohur disa transformime në kontekstin e kohës ku ato kanë ndodhur. E megjithatë ai nuk ka reshtur kurrë së kryeri misionin e tij, edukimin patriotik të të gjithë brezave që i kanë shërbyer dhe vazhdojnë t'i shërbejnë mbrojtjes së vendit dhe sigurisë kombëtare.

Në Konceptin e Arsimit të FA-ve, ky proces si dhe ai i trajnimit, stërvitjes dhe vlerësimit konsolidohen më tej, në përputhje me standardet më të përparuara të NATO-s dhe objektivi kryesor i këtij sistemi mbetet mbështetja e Forcave të Armatosura me personel profesional për përmbushjen e të gjithë spektrit të detyrave operacionale. Ai duhet t'i nënshtrohet një transformimi të thellë, ku përparësi mbetet përgatitja e ushtarit profesionist, nënofficerit, oficerit të trupës e shtabeve dhe civileve të FA-ve për të gjitha nivelet.

Cili është faktori bazë i vijimësisë së arsimit bashkëkohor ushtarak?

Arsimi ushtarak nuk është një risi në sistemin tonë arsimor. Më vjen mirë që edhe ju, në pyetjen tuaj keni përdorur si term konceptin e "vijimësisë". Pra, shfrytëzimi i elementit tradicional, ose asaj që shpesh herë ne e konsiderojmë si "shkolla e vjetër/apo shkolla klasike" ngelet një element bazë. Kjo do të thotë që edhe arsimit bashkëkohor ushtarak duhet të ketë si shtyllë kryesore edukimin patriotik të profesionistëve të rinj në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Krijimi i një vakumi prej gati 15 vitesh, që erdhi si pasojë e mbylljes së arsimit të lartë ushtarak në vend, tregoi se pavarësisht përgatitjes së lartë profesionale të oficerëve të rinj në akademitë më prestigjioze të vendeve partnere, fryma atdhetare e tyre ishte një element i munguar. Në ndryshim nga studentët tanë të Bachelor-it, të hapur në shtator të vitit 2020, që çdo mëngjes këndojnë himnin kombëtar, ky grupim ushtarakësh për fat të keq nuk e morën dot këtë edukim. Prandaj, që vijimësia të jetë e suksesshme dhe e qëndrueshme duhet të kontribuojmë të gjithë në forcimin e arsimit ushtarak vendas, duke marrë më të mirën e asaj që tradita na ofron.

Si është transformuar arsimit ush-

Intervistë me Dr. Etleva Smaçi, zëvendës dekane e Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë



tarak në vite, cilat janë objektivat e AFA-së në këtë drejtim?

Ju e keni prekur pak në hyrje të kësaj interviste idenë se arsimit ushtarak në Shqipëri është transformuar që nga fillimet e tij. Kjo është më se e kuptueshme pasi qëllimi kryesor i përgatitjes së oficerëve për gati 50 vite ishte mbrojtja e vendit nga armiqët e jashtëm dhe të brendshëm. Me ndryshimet demokratike në vend u pa realisht se këta armiq ishin imagjinarë. Për rrjedhojë si gjithë FA-të edhe shkollat ushtarake hynë në proces transformimi. Nuk ka qenë një rrugëtim i lehtë. Numri i studentëve në shkollën e lartë ushtarake ra ndjeshëm. Kjo pasi edhe FA vetë u reduktua vit pas viti. Për sa i përket formave të shkollimit ka pasur disa përpjekje për ta afruar me arsimin civil publik. Le të

kujtojmë për shembull nismën e hapjes së Universitetit Ushtarak në vitin 2004, ku u tentua modeli i dhënies së diplomave të dyfishta, pra diplomë në fushën ushtarake dhe diplomë universitare në një profil të caktuar si ekonomi, informatikë etj.

Sot më lejoni të them modestisht se jemi në fazën më të mirë të transformimit të arsimit ushtarak në veçanti në nivel universitar. E them këtë pasi për herë të parë ne kemi të njëjtën formë të diplomës së nivelit të parë Bachelor si të gjithë universitetet e tjera në vend. Pra japim një diplomë trevjeçare në Shkencën Ushtarake, e licencuar nga MARS me 180 kredite, që i mundëson çdo të riu/të reje të vazhdojë studimet e nivelit të dytë master, në fusha të njëjta ose të përafërta. Aktualisht ne jemi duke punuar në përgatitjen e programeve për Master

Profesional dhe Master Shkencor me fokus politikën e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Ky është një angazhim por edhe detyrim moral që ne kemi ndaj studentëve që ata të ndihen të barabartë si të gjithë kolegët e tyre ushtarak në vendet e NATO-s, por edhe me studentët e IAL publike që ndjekin shkollimin sipas modelit 3+1 ose 3+2. Diplomati e lëshuara nga AFA janë në përputhje me kërkesat e Kartës së Bolonjës e njohur në zonën Europiane. Në proces transformimi padyshim AFA dhe FMS do të synojnë për herë të parë në vitin akademik 2021-2022 që me dy programet e reja të studimit të nivelit të parë Bachelor, "Teknologji Informatik në Fushën e Mbrojtjes" dhe "Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes" të orientohet drejt zhvillimeve dhe trendeve të reja edhe në fushën e Mbrojtjes, ku dihet tashmë se teknologjia luan një rol vendimtar.

Unë u ndala pak gjatë tek studimet e nivelit të parë, pasi siç e theksova edhe më lart, ato u finalizuan pas një mungese të gjatë në arsimin e lartë ushtarak me kontributin institucional dhe mbështetjen dashamirëse të Ministrisë të Mbrojtjes dhe Ministrisë të Arsimit duke e rikthyer FA-në në një aktor të rëndësishëm edhe në fushën e edukimit. Për të justifikuar këtë mbështetje është detyrë e AFA-së që me politikën e saj arsimore ta bëjë sa më tërheqës institucionin për të tre nivelet e studimit, jo vetëm për ushtarakët por edhe për civilët që tregojnë interes dhe duan të thellohen në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Zonja Smaçi, ndërsa ju po flisnit për transformimin, mua natyrshëm më shkoi mendja tek një ndër elementet thelbësorë që përcaktojnë transformimet në sistemet arsimore. E kam fjalën për kurrikulën. Për lexuesin unë do të doja që ju të jepnit një panoramë më të gjerë në lidhje me kurrikulën në arsimin ushtarak. Si përzgjidhet dhe zbatohet ajo?

Kurrikula, si një koncept i përgjithshëm nënkupton një sistem të përbërë nga disa elemente me synime arsimore që në bashkërendim me njëra-tjetrën krijojnë mundësi të funksionimit të sistemit arsimor. Vetë kurrikula është një koncept ciklik në ndryshim të vazhdueshëm, pasi ajo është e kushtëzuar drejt për drejt nga konteksti shoqëror, politik, ekonomik dhe së fundmi teknologjik i mjedisit arsimor në të cilin prodhohet dhe konsumohet. Në këto kushte, nevojat për ndryshime kurrikulare që synojnë kompetencat, rishfaqet

gjithnjë e më shpesh si domosdoshmëri në fushën e politikave arsimore, ndaj përbën thelbin e reformave në edukim në përgjithësi dhe atyre kurrikulare, në veçanti.

Në rastin e arsimit ushtarak, nisur nga natyra e tij unike ndryshimet e kurrikulës në këtë fushë harmonizojnë jo vetëm strategjinë arsimore por edhe strategjinë kombëtare të sigurisë. Andaj dhe qasja ndaj kurrikulës së arsimit ushtarak mbetet një domain paksa i "ngurtë" në raport me kurrikulat e arsimore në përgjithësi. Në arsimimin ushtarak kurrikula është një ndër shtyllat kryesore dhe pjesë integrale e ndërtimit të ushtrisë si një institucion me mision shumë të rëndësishëm dhe unik, siç është mbrojtja dhe siguria kombëtare. Nga ana tjetër fakti që ushtarakët tanë i ushtrojnë kompetencat dhe aftësitë e tyre në një mjedis sigurie kompleks kërkon që qasja ndaj arsimimit të jetë multidisiplinare. Kjo do të thotë që aftësimi profesional është vetëm një shtyllë e kurrikulës. Shtylla tjetër shumë e rëndësishme është aftësimi i tyre me kompetenca që zhvillojnë një qytetar me bindje demokratike dhe integritet në publik.

Aktualisht pothuajse në të gjitha akademitë ushtarake perëndimore kurrikula përfshin lëndë akademike që përqendrohen në politikën moderne dhe zhvillimet ushtarake, në lidhjen e ngushtë midis qëllimeve politike dhe përdorimit të mjeteve ushtarake. Integrimi arsimor i historisë, kulturave të huaja, marrëdhëniet ndërkombëtare, shkenca operacionale ushtarake dhe e drejta humanitare i shërben një objektivi të thjeshtë: për të prodhuar një klasë të mirë informuar ushtarake. Këtë ka synuar edhe AFA që prej momentit që u hodh ideja e rikthimit të nivelit të parë të studimeve Bachelor në FMS. Them se kurrikula jonë është e ngjashme në elementet më të rëndësishme me shkollat e tjera të larta të vendeve aleate. Sfidë ngelet padyshim orientimi i saj drejt teknologjisë në kushtet kur armiku nuk është më ai klasik. Së fundmi, pandemia ishte sfida e radhës që ngriti pyetjen si duhet të trajnohet dhe arsimohet një ushtarak për t'u përballur me të ardhmen e paparashikueshme ku armiku është i padukshëm?! Për ta përmbyllur, sfidat intelektuale dhe kulturore janë ato që do të përcaktojnë ndryshimet kurrikulare, krahas vizionit politik për kompetencat e ushtarakut të shekullit të 21-të.

AFA dhe FMS krahas ciklit bach-

elore, që nisi në shtator të vitit 2020, përgatit oficerë të rinj edhe përmes kurseve, siç është kursi njëvjeçar i Përgatitjes së Oficerit të ri. Cili është dallimi mes këtyre dy modeleve arsimore?

Kjo është një pyetje interesante sepse hedh dritë edhe mbi dilemat apo debatin që vetë rrethet ushtarake kanë. Si duhet të përgatiten oficerët e rinj? Të ndjekin një shkollë të lartë 3 vjeçare në nivelin e parë bachelor e më pas të titullohen oficerë, apo të përfundojnë shkollimin civil në profile të ndryshme e më pas të kryejnë një kurs njëvjeçar e në fund të tij të titullohen oficerë. Në fakt ne për herë të parë në këtë vit i aplikuar të dyja modelet. Përmes maturës shtetërore ne pranuan në vitin e parë të bachelorit Shkenca Ushtarake 60 maturantë. Po kështu përmes aplikimit në QPR u pranuan 60 të rinj që kishin përfunduar studimet e larta në profile të ndryshme në KPO, kurs njëvjeçar. Pra, në këtë rast përfitim i FA-së është se këta të rinj janë tashmë të diplomuar dhe ne përpqemi t'u japim përparësi në përzgjedhje atyre të rinjve që kanë profesione për të cilat FA ka nevojë. Interes paraqesin të diplomuarit në degët e TIK, ekonomisë apo edhe në shkencave të tjera ekzakte si p.sh., kimia etj. Edhe pse programi është i shkurtuar nga pikëpamja kohore në raport me studentët që përfundojnë Shkencat Ushtarake, ai është i ndërthurur bazuar në modelet më të mira të kurseve të ngjashme, që zhvillohen në SHBA si p.sh., ato të Gardës së New Jersey-it.

Edhe për vitin akademik në vijimësi në AFA/FMS do të vazhdojë arsimimi qoftë në nivelin e parë të studimit qoftë në KPO. Nisur nga nevojat që FA do të ketë për efektivë, me daljen e kuadrove të para nga Bachelor Shkenca Ushtarake, ndoshta do të kemi një pakësim të rekrutimit të të rinjve që janë të diplomuar. Këtu do të ndikojë edhe fakti që FMS do të ketë që prej tetorit të vitit 2021 tre programe studimi, dy prej të cilëve do të jenë në bashkëpunim me Universitetin Aleksandër Moisiu dhe ku gati më shumë se 50% e kurrikulës është e orientuar jo vetëm nga teknologjia por edhe me një qasje më civile.

Ju përmendët pak më lart rekrutimin. Ky është një proces transparent që e zhvillon QPR. Ajo që unë mendoj se në këtë moment ka interes për publikun është padyshim procesi i prani-



meve në shkollat e larta ku bën pjesë edhe FMS. Cilat janë disa nga rrugët apo politikat që AFA/FMS ndjek për të zgjuar interesin e të rinjve për këtë fakultet të ri të shtuar në listën e shkollave të larta në vendin tonë?

Së pari, do të doja të qartësoja faktin se maturantët që aspirojnë të ndjekin një shkollë të lartë ushtarake duhet së fillim të na përzgjedhin. Përse e them këtë? Pranimi në FMS ka specifikat e tij. Por hapi i parë është zgjedhja në formularin e maturës shtetërore e programeve që ne ofrojmë. Vetëm pas kësaj përzgjedhjeje ata mund të bëhen pjesë e garës, e cila pasohet me testimin fizik, intelektual dhe sigurisht disa kriteret e tjera specifike që lidhen me aftësitë shëndetësore apo dhe parametrat fizikë.

Është e kuptueshme që në kohë paqejë roli i FA-së është pak në "hije", kështu në ndryshim me një punonjës policie që është më prezent në komunitet, ushtaraku edhe për nga misioni që ka është më i rezervuar. Kjo bën që ky profesion të mos ketë njohjen e duhur. Për shkak që edhe kurrikula e arsimit të mesëm e të lartë ka pak njohuri për mbrojtjen, madje ato kanë më tepër natyrë historike, maturantët janë pak të paqartë se çfarë përfaqëson në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve profesioni i ushtarakut.

Prandaj, edhe pse në kushtet e vështira të pandemisë, është synuar që nëpërmjet rrjeteve sociale të paraqiten

episod vizive nga jeta ushtarake. Të sillen më afër tek maturantët, ushtarakët e rinj në veçanti që kanë marrë pjesë në misione apo shtabe jashtë vendit. Mendoj se ky vit do të ketë një bum kërkesash, pasi zhvillimi i Defender 21 dhe ditët e hapura ishin një shans shumë i madh për ne por edhe për vetë maturantët për të hyrë sado pak në misteret e Artit Ushtarak.

Shpresojmë shumë që në këtë vit të mund të jemi më të pranishëm në të gjitha gjimnazet e Shqipërisë. Kjo do të jetë edhe një sfidë, jo thjesht të tërheqim maturantë, por të tërheqim më të mirët. Sepse ka një objektiv të formuluar qartë nga Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, që AFA t'i përngjasojë në shëmbëlltje akademisë më prestigjioze në botë West Point.

Për sa i përket pyetjes suaj përse maturantët duhet të na zgjedhin, padashur të përsëris disa nga përfitimet që ata kanë, do të thosha së pari, se profesioni i ushtarakut është një profesion elitare kudo në botë. Ai lidhet ngushtësisht me atdheun, patriotizmin, virtytet që jo çdo profesion i përçon. Gjithashtu koncepti i këtij profesioni nuk është më në suazën e ngushtë të vendit. Anëtarësimi në NATO dhe mbrojtja kolektive ka bërë që ushtaraku shqiptar të jetë një kontribuues real në mbrojtjen dhe sigurinë e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut. Mendoj se çdo i ri do ta shihnte si një mundësi të artë që të ndërtonte jo thjesht një karri-

erë kombëtare por edhe ndërkombëtare. Dhe shanset në FA, përmes posteve dhe detyrave të ndryshme që ajo ofron që në shkollët më të ulëta të gradave, janë shumë më të mëdha.

Meqë ju përmendët karrierën ndërkombëtare, që tashmë nuk është më një "tabu" në FA, si i përgatitni studentët tuaj, jo vetëm ata të Bachelor-it por edhe ushtarakët që ndjekin kurse institucionale të karrierës për një kulturë komunikimi sa më të mirë kur shkojnë në misione, përfaqësi apo shtabe të NATO-s?

FA-të janë shembulli më i mirë i edukimit gjatë gjithë jetës. Në periudha të caktuara me distancë pas përfundimit të shkollës së lartë ata rikthehen në auditorë për periudha të ndryshme kohore që variojnë nga tre muaj deri në një vit, sipas natyrës së kursit dhe hierarkisë së gradës. Këto kurse institucionale i shërbejnë pikërisht përgatitjes së studentëve, jo thjesht me njohuri ushtarake por krijimit të një kulture të gjerë, kur njohja e organizatave ndërkombëtare dhe gjuha angleze janë elementë shumë të rëndësishëm. Për sa i përket gjuhës angleze, por jo vetëm asaj, AFA ka të përfshirë në strukturat ndihmëse akademike Qendrën e Gjuhëve të Huaja. Ky është edhe një tjetër përfitim i çdo studenti që vjen në shkollë të lartë ushtarake. Ai nuk shpenzon asgjë po kështu edhe ushtarakët

e tjerë nga buxheti i tij për mësimin e gjuhëve të huaja. Ato mbulohen tërësisht me buxhetin e MM. Mësimdhënia e gjuhëve të huaja bëhet me profesionistë të fushës, pjesa më e madhe e të cilëve janë trajnuar në qendra të ngjashme në Amerikë, Angli, Gjermani etj. Njohja e anglishtes dhe gjuhëve të huaja nuk konsiderohet privilegj në FA por detyrë.

Ç' mund të na thoni për kapacitetin logjistik që ju si Fakultet zotëroni. A janë ato të përshtatshme për një mësimdhënie sa më efektive?

Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë si "rishtar" kishte sivjet 60 studentë Bachelori. Por në të njëjtët auditorë bënte mësim edhe KPO. Për vitin akademik 2021-2022 janë planifikuar të jenë në auditorë edhe 120 studentë të tjerë që do të thotë trefishim i tyre. Mjediset akademike janë të pamjaftueshme. Ndihet nevoja për një kampus studentor. Jo vetëm për klasa dhe kabinete, por edhe për ambiente sportive ku studentët të kalojnë kohën e lirë. Kampusi studentor është pjesë e dinjitetit të një shkolle elitë, aq më tepër shkolle ushtarake. Nuk mungon dëshira dhe ka vullnet dhe projekte tepër ambicioze në këtë drejtim. Ashtu si ka përpjekje shumë të mira edhe për të pasuruar bazën materiale mësimore me tekste të përgatitura nga vetë stafi akademik, duke ju kthyer traditës së librit dhe jo përkthimeve shabllon. Të gjitha këto synojnë që akademia të mos ketë imazhin e një reparti rutinë por të një qendre arsimore kërkimore me standarde kombëtare e pse jo dhe ndërkombëtare.

Së fundmi, do të doja t'ju drejtoja një pyetje pak më personale. Ju jeni civile, Dr. shkencash në Histori, me specialitet Histori Ushtarake dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Prej disa muajsh jeni edhe zëvendës dekane e FMS. Si e gjeni veten në këtë mjedis?

Po është e vërtetë që pjesën më të madhe të karrierës sime akademike e kam zhvilluar jashtë mjedisit ushtarak. Fillimet në vitin 2015 kanë qenë një sfidë, edhe pse jam vajzë ushtaraku dhe disi e njihja natyrën e këtij profesioni. Edhe për sa i përket angazhimit profesional fokusi kryesor kishte qenë Filologjia dhe Historia e Përgjithshme. Ardha në Akademi fillimisht si pedagoge ka qenë një mundësi e jashtëzakonshme për të hulumtuar në Arkivin Qendror të FA-së. Historia Ushtarake njihet pak te ne. Edhe ata që kanë punuar për vite të tëra në këtë fushë janë pak të përmendur. Ky fakt më ngacmon vazhdimisht si kërkuese shkencore të hap një dritare më të madhe që Akademia të mos ngelet vetëm brenda mureve të garnizonit Skënderbej.

Si zëvendës dekane, kam pasur nderin të jem e para grua dhe civile në këtë detyrë. Nuk është e lehtë kur rrethohesh me kolegë ushtarakë karriere por që janë tepër mbështetës. Unë e kam parë këtë detyrë edhe si një frymë që ndihet kudo në FA në kuadër të nismave të barazisë gjinore, sidomos në nivelet e larta të drejtimit. E kam parë edhe si një filozofi të lidhshëm për ta hapur akademinë përtej rrethëve ushtarake dhe për t'u dhënë atyre lirinë akademike që është dhe themeli i çdo institucioni arsimor. Ju falënderoj për intervistën!



NATO përkujtoi njëzet vjetorin e sulmeve të 11 shtatorit

Stoltenberg: "Ne duhet të vazhdojmë të qëndrojmë së bashku"

Njëzet vjet më parë si sot, në orën 8.46 të mëngjesit, Fluturimi 11 i American Airlines, mbi Kullën Veriore të Qendrës Tregtare Botërore, shënoi fillimin e një seri sulmesh terroriste të qëllimshme dhe vdekjeprurëse. Atë mëngjes, 2,977 njerëz të pafajshëm vdiqën në Nju Jork, Uashington dhe Pensilvani. Në këtë përvjetor të njëzetë, ne kujtojmë dhe nderojmë ata që vdiqën dhe ata, jeta e të cilëve u ndryshua në mënyrë të pakthyeshme në atë mëngjes të ndritshëm shtatori.

11 Shtatori dëshmoi më të keqen e njerëzimit, por gjithashtu nxori në pah më të mirën. Nga reaguesit e parë që vrapuan drejt ndërtesave për të ndihmuar, ndërkohë që të tjerët po dilnin, tek personeli mjekësor që shpëtoi kaq shumë jetë dhe tek burrat e gratë e zakonshme që bënë gjithçka që mundën për të ndihmuar bashkëqytetarët e tyre.

11 shtatori nuk ishte vetëm një sulm ndaj Shteteve të Bashkuara, ishte një sulm ndaj të gjithëve ne. Viktimat vinin nga çdo cep i aleancës së NATO-s dhe nga përtej saj. Brenda 24 orëve nga sulmet, aleatët e NATO-s thirrën, për herë të parë, Nenin 5, klauzolën tonë të mbrojtjes reciproke, e cila thotë se një sulm ndaj një aleati është një sulm ndaj çdo aleati. Menjëherë pas kësaj, forcat e NATO-s ishin në Afganistan krah për krah.

Angazhimi ynë në Afganistan tani ka marrë fund. Ka qenë i gjatë dhe i vështirë, me një kosto të madhe, në gjak dhe thesar. Mbi një milion burra dhe gra tanë me uniformë, nga Amerika e Veriut, Evropa dhe shumë vende të tjera partnere, shërbyen atje gjatë dy dekadave të fundit. Mijëra sakrifikuam jetën e tyre, ose u plagosën, së bashku me shumë afganë, si nga forcat e sigurisë ashtu edhe nga civilët, por në të njëjtën kohë, ne nuk duhet të harrojmë atë që kemi arritur së bashku. Në vitin 2001, Afganistani ishte një strehë e sigurt për terroristët e Al Kaedës që planifikuan dhe kryen sulmet e 11 Shtatorit, dhe shumë më tepër në të gjithë botën. Misioni i NATO-s ishte të degradonte al Kaedën dhe të parandalonte Afganistanin që të shërbente si një bazë nisjeje për terroristët që do të na sulmonin. Që nga 11 Shtatori, nuk ka pasur sulme terroriste kundër vendeve tona të organizuar nga Afganistani.

Komuniteti ndërkombëtar, i mbështetur nga forcat ushtarake të NATO-s, gjithashtu ndihmoi në krijimin e kushteve që i lejuan afganët të përmirësojnë jetën e tyre. Një brez i ri burrash dhe grash janë rritur në gjendje të arsimohesh, të marrin pjesë në procesin politik dhe të lidhen me pjesën tjetër të botës. Ato përfitime nuk mund të kthehen lehtë.

Bota i ka sytë nga Afganistani dhe do t'i detyrojë ata që janë në pushtet të mbajnë zotimet e tyre. Ata duhet të parandalojnë strehën e sigurt për terroristët, të rrespektojnë të drejtat e njeriut dhe



të sigurojnë kalim të sigurt për ata që e kërkojnë atë, si dhe qasje humanitare.

Ngjarjet e javëve të fundit janë një tragjedi për afganët dhe na kanë shkaktuar trishtim të gjithëve ne që i mbështesim ata. Në të vërtetë, ka shumë pyetje të vështira që duhet të bëjmë me sinqeritet në lidhje me angazhimin tonë. Ka mësim që të gjithë duhet t'i mësojmë. Në NATO, ne kemi nisur një vlerësim të plotë. Është shumë herët për të gjykuar paraprakisht rezultatet, por për mendimin tim, ka disa gjëra që spikasinqartë.

Afganistani nuk do të jetë kriza e fundit për të cilën Amerika e Veriut dhe Evropa duhet të veprojnë së bashku përmes NATO-s. Gjithmonë do të ketë nga ata që dëshirojnë të na dëmtojnë. Ne e pamë këtë në 11 Shtator dhe në shumë sulme të tjera terroriste që nga ajo kohë. Ne gjithashtu e pamë atë në Irak dhe Siri kur ISIS mori kontrollin e një pjese të madhe të territorit për të krijuar një regjim terrorist jashtëzakonisht brutal. ISIS nuk do të angazhohet kurrë në diplomaci. Vetëm falë aleatëve të NATO-s dhe partnerëve tanë që vendosën forcat ushtarake, ne ishim në gjendje të çlironim tokën dhe njerëzit e kontrolluar nga ISIS. Aksioni ushtarak është gjithmonë zgjidhja e fundit, por ndonjëherë është e vetmja përgjigje racionale.

Përdorimi i forcës nuk është vetëm një pjesë thelbësore e luftimit të terrorizmit. Forca ushtarake është garantuesi përfundimtar i lirisë sonë. Pa një ushtri të fortë dhe të besueshme për ta mbështetur atë, diplomacia do të dështojë. Gjatë Luftës së Ftohtë, ishte fuqia ushtarake e

NATO-s ajo që i dha forcë diplomatëve dhe politikanëve tanë për të negociuar me Bashkimin Sovjetik.

Një ushtri e fortë, e kombinuar me vullnetin për ta përdorur atë kur është e nevojshme, është thelbi i parandalimit tonë. Imagjinoni sikur NATO të mos kishte forca ushtarake të forta dhe të afta, por konkurrentët tanë të kishin. Atëherë ne nuk do të ishim në gjendje

të garantim vlerat tona më të dashura: lirinë, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Forcat tona të armatosura i kanë mbajtur kombet tona të sigurta për më shumë se shtatëdhjetë vjet dhe do të vazhdojnë të na mbajnë të sigurt në dekadat e ardhshme.

Ka edhe raste kur diplomacia dësh-ton dhe opsioni ushtarak është i vetmi i mbetur. Ky ishte rasti në vitet 1990, kur luftërat në Ballkanin Perëndimor u

përfunduan vetëm me aksion ushtarak. Jetë të panumërta të pafajshme u shpëtuan nga ndërhyrja e NATO-s në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe më pas në Kosovë.

Zhvillimet dramatike në Afganistan gjithashtu demonstrojnë një mësim tjetër të qartë për mua. Në një botë më të paparashikueshme dhe konkurruese, sfidat me të cilat përballemi janë tepër të mëdha për çdo vend, apo çdo kontinent, që të arrijë t'ia dalë i vetëm.

Ndërsa kujtojmë të gjithë ata që vdiqën në 11 Shtator, dhe të gjithë ata që kanë sakrifikuar aq shumë në vitet që pasuan, ne gjithashtu duhet të kujtojmë solidaritetin që na lidhi në ato orë të errëta. Njëzet vite më parë Amerika e Veriut dhe Evropa ishin së bashku. Ne duhet të vazhdojmë të qëndrojmë së bashku për të qëndruar të sigurt sot dhe nesër.

Për të nderuar viktimat e sulmeve të 11 shtatorit dhe sakrificat e pjesëtarëve të shërbimit, flamujt u ulën në gjysmë shtizë në Shtabin e NATO-s, si dhe në Operacionet e Komandës Aleate në Mons, Belgjikë dhe në Komandën Aleate të Transformimit në Norfolk, Virxhinia.

Ceremonia në selinë e NATO-s përfshiu një moment heshtjeje në orën 14:46 me orën lokale në Bruksel, minutën e saktë të sulmit të parë në Kullën Veriore të Qendrës Tregtare Botërore në Nju Jork njëzet vjet më parë.



Rifillojnë negociatat lidhur me kërkesën e Katalonjës për pavarësi

Kryeministri spanjoll, Pedro Sanchez dhe lideri katalanas, Pere Aragonès, u takuan për të rifilluar bisedimet për zgjidhjen e krizës politike, shkaktuar nga lëvizja separatiste në rajonin spanjoll. Takimi u mbajt dje në selinë e Qeverisë së Katalonjës në qendër të Barcelonës.

Pas takimit, Sanchez u tha gazetarëve se ishte shumë e rëndësishme që të ketë një dialog mes dy palëve. “Ekziston një ndryshim rrënjësor midis pikëpamjeve tona dhe pikëpamjeve të qeverisë lokale në Katalonjë për zgjidhjen e çështjes katalanase. Nga ana tjetër, ne jemi të bindur se dialogu është mënyra më e mirë për të afruar qëndrimet. Çështja katalanase nuk është një problem që filloi dje dhe mund të zgjidhet nesër. Prandaj, bisedimet do të vazhdojnë pa nxitim, pa ndërprerje dhe pa ndonjë afat”, -tha Sanchez. “Të dyja palët duan të gjejnë një zgjidhje të bazuar në dialog dhe marrëveshje. Duam që Katalonja të kompensojë dhjetë vitet e humbura. Katalonja dhe Spanja meritojnë një të ardhme më të mirë”, -theksoi kryeministri spanjoll. Udhëheqësi katalanas, Aragonès, tha se megjithëse ata përfaqësojnë një qëndrim shumë më ndryshe nga qeveria qendrore, ata ende janë në fillim të negociatave dhe po përpiqen të ndërtojnë besim reciprok.

“Kemi nevojë për kohë dhe durim.



Po përballemi me një krizë politike që kërkon një zgjidhje politike që qytetarët e Katalonjës do ta miratonin. Pavarësia e Katalonjës, e cila duhet të përcaktohet me referendum, si dhe njohja e saj nga bashkësia ndërkombëtare duhet të

jetë një proces legjitim dhe racional. Demokracia është mënyra më legjitime për të zgjidhur mosmarrëveshjet politike. Askush në Katalonjë nuk ëndërron për një zgjidhje krejtësisht jodemokratike”, -tha Aragonès.

Aragonès dhe e majta e tij republikane e Katalonjës i konsiderojnë këto negociata një “mundësi historike”.

Negociatat vijnë në një kohë kur 7.5 milionë katalanas janë të ndarë në dy kampe afërsisht të barabarta. Sondazhet

dhe rezultatet e zgjedhjeve gjatë pesë viteve të fundit tregojnë se gjysma e Katalonjës dëshiron të qëndrojë me Spanjën, ndërsa gjysma tjetër dëshiron të ndërpresë të gjitha marrëdhëniet me Madridin.

“Ekziston një ndryshim rrënjësor midis pikëpamjeve tona dhe pikëpamjeve të qeverisë lokale në Katalonjë për zgjidhjen e çështjes katalanase. Nga ana tjetër, ne jemi të bindur se dialogu është mënyra më e mirë për të afruar qëndrimet. Çështja katalanase nuk është një problem që filloi dje dhe mund të zgjidhet nesër. Prandaj, bisedimet do të vazhdojnë pa nxitim, pa ndërprerje dhe pa ndonjë afat”, -tha Sanchez.

14 miliardë euro Ballkanit, ndihmë nga BE

Deputetët e Parlamentit European u dhanë dritën jeshile paketës së re financiare, prej 14,2 miliardë euro, për shtatë shtetet e përfshira në procesin e zgjerimit të BE-së.

Këto para do të ndahen për Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Kosovën, Malin e zi, Serbinë dhe Turqinë për një periudhë shtatëvjeçare deri në vitin 2027. Fjala është për fonde që do t'i ndihmojnë këto shtete të kryejnë reformat e kërkuara në procesin e para anëtarësimit. Risia kësaj radhe është rritja e rolit të Parlamentit European për të kontrolluar shfrytëzimin e këtyre fondeve dhe mundësia që ato të zvogëlohen, apo edhe të pezullohen, për ato shtete të cilat nuk do të respektojnë parimet e sundimit të ligjit.

“Qëllimi i përgjithshëm i IPA III është të mbështeten këto vende në miratimin dhe zbatimin



e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike për t'u përshtatur me vlerat e BE-së dhe gradualisht të inkuadrohen me ligjet, standardet dhe politikat e BE-së”, -thuhet në deklaratën e PE-së. Parlamenti kësaj radhe e ka bërë të qartë se nuk do të hezitojë që të pezullohet ndihma e cila do të kushtëzohet me sundimin e ligjit nga këto vende candidate dhe candidate potenciale.

“Ky fond, gjenerata e tretë e IPA, mund të zvogëlojë apo pezullojë asistencën nëse respektimi i vlerave themelore – demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit shënon përkeqësim. Si pasojë, shfrytëzimi i fondeve nga IPA do të kushtëzohet me respektin e këtyre vlerave nga ana e shtetit përkatës”, -ka paralajmëruar Parlamenti European.

Studimi për uniformat në Forcat e Armatosura, ku kontribuuan komandat e FT, FA, FD, me specialist të logjistikës, dhe pas përfundimit të mostrave për çdo armë e shërbim, me të gjitha dekoracionet sipas gradave të armëve dhe shërbimeve, u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave

Uniforma Ushtarake, kjo Përfaqësi Historike në kohë lufte dhe paqe

Figura e Ali Pashë Tepelenës, e trajtuar si një figurë me impakt të fuqishëm, në gjallje të tij u pa si një “despot oriental” nga turistët europianë apo dhe studiuesit historikë. I ndikuar nga influenca e rrymës së Filo-Helenizmit që mbizotëronte në atë kohë por dhe në kundërshtim me çfarë shprehte popullsia greke, ai konsiderohej si dhunues dhe shtypës i asaj që kishte mbetur nga Greqia e Lashtë.

Gjatë shekujve të mëparshëm popullsia shqiptare në përgjithësi kishte qenë një element force, ndaj të gjitha Fuqitë e Mëdha me të cilat Ali Pasha hyri në marrëdhënie diplomatike u përpoqën ta përdornin në kundërshtitë që kishin me njëra-tjetrën në rajon, por kurrë nuk i dhanë mbështetjen e duhur diplomatike, për të shpallur pavarësinë.

Veshja e ushtarit shqiptar të kohës së Ali Pashë Tepelenës ishte një kombinim midis petkave të lehta dhe fustanellës e cila u mbajt edhe në uniformën e Regjimentit “Gjuajtësit e Orientit” të formuar në ishujt Jonianë më 1807.

“Gjuajtësit e Orientit” ishte një regjiment i formuar kryesisht nga suljotët dhe nga shqiptarët e tjerë jashtë vendit, që ofronin shërbimin tradicional të mercenarit por të cilët edhe kishin braktisur vendet e tyre si rezultat i armiqësisë që kishin pasur me pushtetin e centralizuar të Ali Pashë Tepelenës.

Fustanella shqiptare, e cila duke qenë më shumë e pëlqyer mes popullsisë të Ballkanit u imitua më shumë nga popujt e tjerë më të largët. Me këtë veshje diçka udhëtarë të huaj në XVIII-XIX vërejnë se ishin të veshur truprojat e oborreve princërore të Moldavisë, të Vllahisë në Bukuresht. Gjithashtu Major William Martin Leak, përfaqësues i Anglisë në Janinë, që kishte pasur mundësinë t’i vizitonte para Bajronit këto zona, kishte shkruar që në 1805: “Veshja shqiptare po bëhet përditë e më e zakonshme, si në More edhe në pjesët e tjera të Greqisë, në këtë të fundit për shkak edhe të rritjes së madhe të fuqisë shqiptare. Kjo veshje është më e lehtë dhe më e volitshme se ajo turke ose greke”. Të gjitha këto dëshmi hedhin dritë mbi influencën dhe “ekspansionin” etnografik, nëse mund ta quajmë kështu, të shqiptarëve që duke qenë elita ushtarake e Pashallëkut të Janinës, përveç zakoneve dhe mjeshtrive të tyre të luftimit u kishin imponuar nga ana estetike dhe veshjen e tyre kombëtare popullsisë të tjera në Ballkan.

Ndikimet dhe fryma kombëtare në uniformat e Ushtrisë Shqiptare

Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, 28 Nëntor 1912-1922, lëshoi udhëzime për të mbajtur në përdorim veshjen e ish-xhandarmërisë apo të ushtrisë turke. Për t’u dalluar që ishin në shërbim të Qeverisë Shqiptare, këtyre veshjeve iu qepën sipër jakave shirita kuqezi, kurse në kapele (qeleshe) një shqiponjë të zezë. Në pamundësi të tyre u udhëzua që në krah të vendosej një shirit kuqezi që përfaqësonte simbolin kombëtar shqiptar.

Më 1913, qeveria mori masa të vishte si uniformë atë të përshtatshmen, dalluesen e xhandarmërisë së sapofor-

muar. Veshja me të cilën u pajis xhandarmëria shqiptare, për arsye të shpjegueshme për atë kohë si dhe për faktin se nuk ishin ideuar apo qepur në Shqipëri, nuk kishte veçori apo karakteristika kom-

bëtare, në prerje apo në qepje. Ajo ishte uniformë ushtarake italiane me ngjyra gri-jeshile, kapela (kësula ushtarake) ishte pa strehë, gradat ishin vendosur në pjesën e përparme të jakës së xhakatës,

për oficerët me yje, për nënoficerët dhe tatarët me shirita mëndafshi me ngjyrë të verdhë. Për t’i dhënë kësaj uniforme një karakter dallues kombëtar jaka ishte punuar me copë kuqezi.

Imitimi i sllavëve dhe sovjetikëve

Kohët që pasuan sollën veshje, të cilat ishin një përshtatje e atyre të “aleatëve” apo “padronëve të radhës”, duke ia nisur që nga Italia e deri tek Kina. Fotot që po botojmë, e ilustronjë më mirë këtë pretendim, ndërsa shih për shembull, ushtarakë shqiptarë në dy kohë të ndryshme, si ajo e Zogut dhe ajo e monizmit, në dekadën e “miqësisë së pathyeshme” me ish-Bashkimin Sovjetik, ku fare lehtësisht mund të besosh se shih anëtarë të Ushtrisë së Kuqe, e jo shqiptarë.

Më parë, menjëherë pas Luftës, uniforma e Ushtrisë Shqiptare (por edhe e Policisë dhe Sigurimit) do të ishte një kopje 100% e asaj jugosllave, ku pustina do të vijonte të qëndronte edhe më tej në kohë.

Uniformat kineze

Më vonë do të viheshin re edhe tendencat kineze në uniformat shqiptare, që do të sillnin veç të tjerash, edhe një “risi” ekstreme në këtë aspekt: do të hiqnin fare gradat e oficerët mund t’i ngatëroje lehtësisht me ndonjë karrocier. Kjo marrëzi vijoi deri në rënien e regjimit në vitin 1991.

Veshja fashiste u përdor edhe pas rënies së Italisë

Por para saj, do të mbizotëronte ajo e Ushtrisë Fashiste, veshje me të cilat do të shiheshin rëndom jo vetëm hierarkët fashistë shqiptarë, por edhe anëtarët e Milicisë. Më 18 shtator 1939, Jakomon nënshkroi dekretin për krijimin e milicisë fashiste, një nga organizmat e parë të Partisë Fashiste Shqiptare. Kjo strukturë bënte pjesë në Milicinë Vullnetare për Sigurimin Kombëtar. Kjo milici “garantonte zhvillimet e revolucionit fashist”, por angazhohej edhe si trupë elitare në kuadër të ushtrisë. Megjithatë në to shihen qartë edhe simbole kombëtare, si plisa apo qeleshe, e madje shkonte edhe më tej, kur shih se anëtarët e “Gardës Mbretërore” (Guardia Reale Albanese) parakolonin në mes të Romës, të veshur tërësisht në kostume kombëtare shqiptare. Më tej, ndërsa oficerët do t’i riktheheshin uniformave të monarkisë (duke u hequr sidoqoftë simbolin e Zogut) ushtarët e Ushtrisë Kombëtare të ringritur gjatë kohës së Regjencës gjatë periudhës së pushtimit gjerman, pas kapitullimit të Italisë, do të vijonin t’i mbanin në pjesën më të madhe për nevojat utilitare uniformat e ushtrisë italiane, tashmë me emblemën e “shtetit të ripavarësuar” shqiptar.



Tefik Mborja dhe hierarkët fashistë shqiptarë në vitin 1941, me veshje të njehta me ato të “kolëgeve” italianë



Nga ekspozita e vitit 2002, “Shqiptar në uniformë”. Çelur pranë Galerisë së Arteve në Tiranë



Anëtarë të misioneve britanike në vitet 1943-44 dhe krerë nacionalistë shqiptarë



Partizanët dhe nacionalistët përdorën xhaketat angleze

Ndër partizanët, madje ndër forcat nacionaliste, do të shiheshin rëndom uniformat britanike, të parashutuara si ndihma nga aleatët në Luftë ndaj gjermanëve.

Postmonizmi dhe kamuflazhet e të gjitha ngjyrave

Periudha e demokracisë do të shihte shumëllojshmëri uniformash që reflektonin edhe varësinë e Ushtrisë Shqiptare nga ndihmat e ushtrive mike, pa mundur të krijohej dot një model që reflektonte traditën shqiptare. Shihje rëndom në vitet '90 kamuflazhe lara-lara e eksperimente të dështuara për të unifikuar, sistemuar e organizuar më mirë punën në këtë aspekt, por do të duhej të kalonin shumë vite derisa të vihej re një tendencë pozitive, edhe pse ajo reflekton sërish një qasje (edhe pse jo negative) imituese përballë aleatëve tanë strategjikë.

Aktualisht, prej vitesh, sidomos pas anëtarësimit në NATO, vihet re një disiplinim edhe në këtë aspekt, duke sjellë më shumë dinjitet e seriozitet për Forcat tona të Armatosura. Në vitin 2002, u hap Ekspozita "Shteti shqiptar në uniforma".

Siç do të kujtojmë më vonë studiuesi Artan Lame, "Në dhjetor 2002, me rastin e 90-vjetorit të Ushtrisë, u hap në Galerinë e Arteve, Ekspozita "Shteti shqiptar në uniforma".

"Shteti shqiptar vuri në dispozicion djelmohat e Gardës dhe korentin, unë vura në dispozicion koleksionin tim të uniformave dhe... rezultati. Ekspozita qëndroi e hapur vetëm 4 orë, aq sa mund të rrinin pa ngrënë djemtë e mrekullueshëm të Gardës. Megjithatë ishte një sukses i jashtëzakonshëm dhe, për ditë me radhë, vijuan të shkonin njerëz në Galeri me dëshirën për të parë ekspozitën që nuk ishte më".

Pranë Akademisë së Mbrojtjes, në kuadër të përmirësimit dhe kompletimit të uniformave ushtarake ngrihet grupi i punës

Në vitin 2004-2005 u bë një studim për uniformat në forcat e armatosura, ku kontribuuan komandat e FT, FA, FD, me specialist të logjistikës, dhe pas përfundimit të mostrave për çdo armë e shërbim, me të gjitha dekoracionet sipas gradave të armëve dhe shërbimeve, u

miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave. Mbi këtë bazë u përgatit albumi i forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, një punë shkencore dhe kombëtare, mbi bazën e traditës shqiptare, përshtatur dhe me uniformat e NATO-s.

Është punuar në vite që të shkohet drejt një standardizimi të plotë të uniformës dhe së fundmi është mbledhur grupi i punës me specialistë të fushës, për rishikimin e modelit të uniformave,

për përmirësimin, hartimin dhe kompletimin e dizajneve, stilimeve, treguesve teknik të uniformave ushtarake, stemave, simboleve dhe shenjave të tjera dalluese të uniformës ushtarake që mban personeli ushtarak i Forcave të Armatosura të RSH. I miratuar me V.K.M nr. 694, datë 21.11.2018 si dhe ato që kanë qenë pjesë e V.K.M nr. 503, datë 13.7.2011 me synim, sigurimin e një prezantimi dinjitoz të ushtarakut të FARSH, mbartjen



e simbolikave që evidentojnë identitetin kombëtar dhe sigurimin e lirshmërisë së personelit në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme të përditshme, gjatë stërvitjeve dhe operacioneve brenda dhe jashtë vendit të uniformës ushtarake që mbajnë FARSH.

1. Rregullorja e Uniformave Ushtarake të Forcave të Armatosura të Repub-



Veshja e uniformës ceremoniale me medaljet përcaktohet me urdhër të komandës së njësisë ose garnizonit ushtarak. Uniforma e Forcave Territoriale kur përdoret në stërvitje dhe kohë lufte, mund të vishet edhe uniformë e përzier (civile-ushtarake) sipas rasteve dhe nevojave operative.

Uniforma ceremoniale për efektivin



likës së Shqipërisë është akti normativ me të cilin rregullohet veprimtaria e strukturave të FA-së, në lidhje me përdorimin e uniformave, rregullat e përdorimit të tyre si dhe pamjen e jashtme të personelit ushtarak të FA-së.

2. Rregullorja trajton kritere dhe rregulla të përgjithshme për përdorimin e uniformës së FA-së, llojet e uniformave sipas qëllimit të përdorimit, kompetencat dhe përgjegjësitë e strukturave ushtarake Në të gjitha nivelet e komandimit të FA-së, në raport me zbatimin e kësaj rregulloreje.

3. Rregullorja trajton në mënyrë specifike, llojet e stemave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe institucioneve të varësisë, flamujt dekorativë të njësive kryesore të FA-së.

4. Rregullorja trajton qartazi përdorimin e uniformës ushtarake ceremoniale nga ushtarakët e dalë në rezervë dhe veteranët e luftës, gjatë kohës kur ata marrin pjesë në ceremonitë kombëtare dhe lokale, përvjetorë që organizohen nga njësia ku kanë shërbyer, ceremonitë e betimit, kortezhe të përmotshme, festa familjare.

e Orkestrës Frymore dhe për Truprojën e Nderit, vishet vetëm në raste pritje zyrtare dhe me urdhër të veçantë.

Ministri i Mbrojtjes ka të drejtë të caktojë se cilët ushtarakë mund të mbajnë veshje civile në vend të uniformës ushtarake.

Oficerët e Forcave të Armatosura që nxirren në rezervë ose pension me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes për raste invaliditeti, plotësim moshe, arsye shëndetësore, shkurtim organike dhe transferim në sektorë të tjerë civilë të pushtetit, kanë të drejtë të mbajnë uniformën ushtarake (me shenjën dalluese në supë), të përcaktuar me urdhrin e daljes në rezervë ose pension.

Burime të marra nga:

1) z. Dorian Koci, studiues i historisë, Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar.

2) z. Artan Lame, studiues i historisë shqiptare.

3) z. Aslan Zemani (drejtor i Muzeut Ushtarak, historian).

4) Rregullorja e Uniformës të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Punoi: Anjeza Musollari



Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, gjatë vizitës së tij që zhvilloi në Mbretërinë e Bashkuar, më 15 shtator, vizitoi Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst, e cila është një ndër akademitë ushtarake më të njohura në Botë. Në këtë Qendër, përveç oficerëve të ushtrisë britanike dhe shumë vendeve të botës, studimet i realizojnë edhe oficerët e FSK-së. Me këtë rast, Ministri Mehaj u prit edhe nga komandanti i Akademisë Ushtarake Mbretërore Sandhurst, gjeneralmajor Duncan Francis Capps.



Bashkëpunimi me akademinë Sandhurst

Ministri Mehaj vizitoi Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst

Me ftesë zyrtare, Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj udhëtoi për vizitë treditore në Mbretërinë e Bashkuar. Vizita e Ministrit Mehaj në Mbretërinë e Bashkuar është shumë e rëndësishme në procesin e ngritjes së aftësive dhe kapaciteteve operacionale ushtarake të FSK-së dhe dëshmon fuqishëm partneritetin shumë të fortë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar që do të intensifikohet edhe më shumë me Memorandumin e ri.

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, gjatë vizitës së tij që zhvilloi në Mbretërinë e Bashkuar, më 15 shtator, vizitoi Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst, e cila është një ndër akademitë ushtarake më të njohura në Botë. Në këtë Qendër, përveç oficerëve të ushtrisë britanike dhe shumë vendeve të botës, studimet i realizojnë edhe oficerët e FSK-së. Me këtë rast, Ministri Mehaj u prit edhe nga komandanti i Akademisë Ushtarake Mbretërore Sandhurst, gjeneralmajor Duncan Francis Capps. Gjithashtu, gjatë kësaj vizite, ministri takoi edhe studentë-oficerët e FSK-së, të cilët



studiojnë aktualisht në këtë Akademi. Ministri Mehaj me këtë rast theksoi se pritja e ngrohtë miqësore nga gjeneral Capps dhe përshtypjet e ndërsjella

mes studentë-oficerëve dhe stafit të Akademisë ishin dëshmi e fuqishme për zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me akademinë Sandhurst.



Drejtori i Politikave të Mbrojtjes, Faruk Geci, në takim vjetor të organizatës SHBA-Karta e Adriatikut (A5)

Në kuadër të takimit vjetor dyditor në nivel të drejtorëve të politikave të mbrojtjes, të organizatës SHBA-Karta e Adriatikut (A5), që u organizua në Zagreb, mori pjesë drejtori i Politikave të Mbrojtjes së Ministrisë së Mbrojtjes, Faruk Geci. Përgjatë dy sesioneve, pjesëmarrësit nga vendet anëtare dhe vëzhguese trajtuan misionin në proces të BE-së dhe NATO-s dhe sfidat e integritimit evropian dhe euroatlantik të vendeve të Evropës Juglindore; sfidat e menaxhimit në aspektin diplomatik të pandemisë COVID-19; kërcënimet, rreziqet dhe sfidat hibride në Ballkanin Perëndimor; reflektimin e krizave globale aktuale në rajon si dhe mundësitë për angazhimin e ardhshëm të përbashkët A-5 në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO. Në ekspozenë e tij, drejtori Geci prezantoi politikën, qëllimet strategjike dhe vizionin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Republikës së




Kosovës në përgjithësi lidhur me temat e ngritura, duke shprehur vullnetin dhe gatishmërinë e plotë për ofrimin e kontributit të kapaciteteve institucionale të Republikës së Kosovës në përgjithësi, si dhe Ministrisë së Mbrojtjes në veçanti, për menaxhimin dhe tejkalimin e përbashkët të të gjitha sfidave rajonale dhe

më gjerë. Gjithashtu, Drejtori Geci, duke pasur parasysh stadin e zhvillimit dhe avancimit të kapaciteteve shtetërore dhe institucionale, si dhe interesin e përbashkët rajonal, theksoi edhe njëherë nevojën për pranimin e Republikës së Kosovës si anëtare me status të plotë në këtë organizatë.

Ministri Mehaj priti në takim ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly

Në vazhden e takimeve të rregullta me ambasadorët e vendeve mike, ministri Mehaj priti në takim ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly. Në këtë takim u diskutua që përveç bashkëpunimit bilateral në fusha tjera, të vendoset edhe bashkëpunimi në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, me fokus të ofrimit të mbështetjes së forcave të armatosura të Zvicrës në fushat specialistike të tyre. Me këtë rast, ambasadori Kolly shprehu interesimin për zhvillimet aktuale në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe rikonfirmoi zotimin se Zvicra do të vazhdojë të përkrahë Qeverinë e Republikës së Kosovës, përveç fushave tjera, edhe në atë të sigurisë dhe mbrojtjes. Nga ana e tij, ministri Mehaj i shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë ambasadorit Kolly në angazhimin e tij për intensifikimin e bashkëpunimit të ndërsjellë.





“Austria është një nga mbështetësit e zëshëm të rajonit dhe Maqedonisë së Veriut, gjë që është vërtetë për respekt. Dy vendet tona gjithashtu bashkëpunojnë në fushën e mbrojtjes, për të cilën shpresoj se në të ardhmen do të kemi më shumë aktivitete që do të rrisin bashkëpunimin tonë dypalësh. “Është gjë e shkëlqyeshme që Austria vazhdimisht dërgon sinjale inkurajimi në rajon dhe në vendin tonë, për të cilat ne jemi veçanërisht mirënjohës”, -tha Shekerinska.



TAKIM SHEKERINSKA-TANER NË AUSTRI: Maqedonia e Veriut ka bërë përparim të madh, të cilin BE duhet ta vlerësojë

Gjatë konferencës së 14 shtatorit, të ministrave të Mbrojtjes të Ballkanit Perëndimor dhe Austrisë, ministrja Radmilla Shekerinska pati një takim joformal me homologen e saj austriake, Claudia Tanner. Takimi u përqendrua në bashkëpunimin në mbrojtje dhe mbështetjen e Austrisë për integrimin evropian të Maqedonisë së Veriut.

“Austria është një nga mbështetësit e zëshëm të rajonit dhe Maqedonisë së Veriut, gjë që është vërtetë për respekt. Dy vendet tona gjithashtu bashkëpunojnë në fushën e mbrojtjes, për të cilën shpresoj se në të ardhmen do të kemi më shumë aktivitete që do të rrisin bashkëpunimin tonë dypalësh. “Është gjë e shkëlqyeshme që Austria vazhdimisht dërgon sinjale inkurajimi në rajon dhe në vendin tonë, për të cilat ne jemi veçanërisht mirënjohës”, -tha Shekerinska.

Ministrja theksoi se mbështetja nga Austria në situatën e zjarreve dhe gjatë pandemisë dha një konfirmim tjetër se të dy vendet mbajnë marrëdhënie të shkëlqyera dhe se Austria vlerëson arritjet e Maqedonisë së Veriut.

Të dy ministret deklaruan se vendi ynë ka bërë përparim, të cilin BE duhet ta vlerësojë duke hapur negociatat për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në BE.

“Austria do të vazhdojë të mbështesë Maqedoninë e Veriut. Kjo është e rëndësishme, jo vetëm për stabilitetin e rajonit, por edhe për të ardhmen e Unionit në përgjithësi. “Marrëdhëniet tona do të vazhdojnë të zhvillohen përmes dialogut dhe mirëkuptimit reciprok”, -tha ministrja Taner. Në konferencën e djeshme të Ministrave të Mbrojtjes të Ballkanit Perëndimor dhe Austrisë, u nënshkrua një Deklaratë e përbashkët për të forcuar rezistencën e vendeve në rajon dhe për të forcuar dialogun strategjik në marrëdhëniet reciproke dhe marrëdhëniet me BE-në, me theks në krijimin e leadershipit rajonal modern. Konferenca u mbajt në të ashtuquajturin “formatin e Grazit”, të krijuar në takimin në Graz, në vitin 2018 midis vendit tonë, Shqipërisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnje-Hercegovinës, si dhe Austrisë në emër të BE-së.



“Austria do të vazhdojë të mbështesë Maqedoninë e Veriut. Kjo është e rëndësishme, jo vetëm për stabilitetin e rajonit, por edhe për të ardhmen e Unionit në përgjithësi. “Marrëdhëniet tona do të vazhdojnë të zhvillohen përmes dialogut dhe mirëkuptimit reciprok”, -tha ministrja Taner.

Nikoll Kota, patrioti që luftoi për çlirim kombëtar



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Takim me poetin dhe patriotin e madh Naim Frashëri

Nikoll (Kol) Kota ka lindur në qytetin e Korçës, më 15 prill 1858, në një familje atdhetare me tradita të shquara qytetare. Të parët e tij morën pjesë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe mbështetjen krijimin e “Shoqërisë së Stambollit”. Aleksandri, babai i tij, kur ishte nxënës shpërndau në Korçë “Evëtarin” e Naum Panajot Bredhit (Veçilharxhit) dhe më pas u bë tregtar i dëgjuar në Korçë dhe Egjipt. Ditën që erdhi Jani Vreto në Egjipt, shumë shqiptarë që kishin frikë nga “konsultoret” greke, nuk u paraqitën ta takonin, ndërsa shumë të tjerë kontribuan me napolona floriri për botimin e librave shqip. Midis shqiptarëve patriotë që nuk i druhej turkomanëve e grekomanëve ishte Nikoll Kota. Nikolla nuk u mor me tregti, por në moshën 19 vjeçare doli malit për të kullotur bagëtinë e familjes. Në malet e Korçës, Voskopojës e Vithkuqit, ra në kontakt me individë (kaçakë), që kundërshtonin ligjet e administratës Osmane. Në korrik të vitit 1877, Kol Kota me një “grup komitësh” shkoi në Frashër dhe prej andej në Dangëlli, ku u takua me poetin dhe patriotin e madh Naim Frashëri. Atë ditë që mbërriti Kol Kota në Dangëlli, Abdyl Frashëri me të vëllanë Naimin, së bashku me bashkëfshatarët e tyre, krijuan “Lidhjen e Frashërit”. Kol Kota mori pjesë edhe në kuvendin ndërkrainor të Frashërit, mbajtur në qershor të vitit 1880, si një ndër përfaqësuesit e krahinës së Korçës.

Nikollën e mundonte halli i Vatanit. Në muajin maj të vitit 1904, u largua nga Egjipti dhe shkoi në Sofje të Bullgarisë, ku ishte organizuar shoqëria atdhetare “Dëshira”. Atje u takua me shumë patriotë shqiptarë dhe anëtarë të kësaj shoqërie. Në Sofje, informohet për përpjekjet e Bajo Topullit për ngritjen e komitëve dhe të “Komitetit për Mbrojtjen e Kombit”. Bajo kishte ardhur nga Gjirokastra në Manastir dhe së bashku me Feim bej Zavalanin, Gjergj Qirjazin, Jashar Bitinckën, Nuçi Naçin, Riza bej Velçishtin, Grigor Cilken, Qani bej Ypin dhe Sejfi Vllamasin, kishte krijuar “Komitetin e Manastirit”. Më pas, kishte shkuar në Korçë e Kolonjë ku kishte ngritur degë të reja. Qeveria turke e greke, u njoftuan për lëvizjen e shqiptarëve dhe filluan kërkimet për zbulimin e qendrës dhe programit të “Komitetit Shqiptar”. Më 12 shkurt ndodhi masakra e Negovanit, ku andartët grekë dhe grekomanët therën Papa Kriso Negovanin, të parin prift shqiptar që kërkonte shkëputjen e kishës ortodokse shqiptare nga kisha greke.

Nikoll Kota përkrah lëvizjen kombëtare

Nikoll Kota, ndiqte zhvillimet politike dhe patriotike nga Sofja dhe inkurajonte familjarët e tij të përkrahnin lëvizjen kombëtare të Ismail Qemalit, Bajo Topullit dhe Fan Nolit. Në Korçë avokat Vasil Kota me disa anëtarë të



pleqësisë kishtarë, dolën hapur në mbështetje të Fan Nolit dhe kishës autoqefale shqiptare dhe kërkuan ardhjen e Nolit në Korçë. Në Vlorë me porosi të Ismail Qemalit, Thanas Floqi, Sotir Peci, Nuçi Naçi, Spiro J. Koleka e Kadri Gjata, çelën shkollën shqipe “Muradie” dhe themeluan “Lidhjen Kombëtare” për përhapjen e gjuhës shqipe. Në Manastir, nën kujdesin e Feim bej Zavalanit, po organizonin mbajtjen e një kuvendi mbarëkombëtar për “Njësimin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe”. Për realizimin e këtij kuvendi dhe mbarëvajtjen e tij, Feim Zavalani, që ishte kryetar i shoqërisë “Bashkimi” të Manastirit, kërkonte mendimin e intelektualëve, luftëtarëve dhe patriotëve. Lajmet e botuara nga gazetaret e Korçës, të cilat futeshin edhe në Greqi, informonin lidhur me ngjarjet patriotike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Në një artikull redaksional botuar në nëntor të vitit 1908, në prag të mbajtjes të Kongresit të Manastirit, përmendej djali i tij, Llambi Kota, i cili i shkruante Feim Zavalanit, që ta anëtarësonte në atë shoqëri. Një numër më pas, Llambi Nikoll Kota i shkruante përsëri Feim Zavalanit “se mbështeste njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe dhe shkrimin e saj me germa latine”.

Sipas këtyre dokumenteve, Llambi Kota bashkëpunonte me Feim Zavalanin, i cili e vlerësonte dhe i kërkonte mendim lidhur me çështje tepër të rëndësishme me karakter kombëtar.

“Kongresi i Manastirit” u mbajt në datat 14-22 nëntor të vitit 1908, dhe vendosi unanimisht “Njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe dhe shkrimin e tij me shkronja latine”.

Patriotët korçarë që kishin themeluar “Klubin e Diturisë Shqip”, nxitën rininë korçare të formonin një shoqëri kulturore. Më 23 nëntor 1908 djemtë e qytetit, Kostaq Kosturi, Nuçi Lapi, Petraq Krastafillaku, Odhise Kota, Kristaq Furxhi, Gavril Pepo e të tjerë, formuan shoqërinë kulturore “Banda e Lirisë”, e cila do merrej me çështjen kombëtare. Xhonturqit u trembën dhe iu kundërvunë lëvizjes kulturore e patriotike shqiptare, duke organizuar në korrik të vitit 1909, një kongres të dytë i quajtur “Kongresi Xhonturkist”. Për të përballuar mësymjen antishqiptare të xhonturqve, kishës sllave e greke, populli shqiptar dërgoi delegat në atë Kongres, përfaqësuesit e tij më të ditur, të kulturuar dhe të vendosur në mbrojtje të vendimeve të marra në Kongresin e Manastirit. Delegatë të Korçës u zgjodhën Hafës ali Korça, Hymer beu, Loni Logori dhe Llambi

Nikoll Kota. Sipas shtypit të asaj kohe, pas përfundimit të “Kongresit të Dibrës” dhe dështimit të synimeve të xhonturqve për të kthyer germa arabe, delegatët erdhën në Korçë dhe u pritën si heronj nga populli që thërriste dhe i brohoriste... germa tona duam ne... Për të qenë pjesëtar në mesin korçar, Nikoll Kota largohet nga Sofja dhe mbërrin në qytetin e tij të lindjes, që vlonte nga patriotizma dhe dëshira për ta parë mëmëdheun të mëvetësuar. Bashkë me dirigjentin e njohur korçar Viso Mborja dhe të tjerë nga shtresa shoqërore të ndryshme, Nikolla anëtarësohet në shoqërinë “Banda e Lirisë”, duke kontribuar me mjete financiare në aktivitetet e saj kulturore, politike e patriotike. Ndërkohë vëllai i tij Av. Sotir Kota dhe djali xhaxhavit av. Vasil Kota, nxinin Parinë Vendore dhe Pleqësinë Kishtarë kundër sundimit osman dhe i kërkonin qeverisë greke të mbështeste kërkesat e shqiptarëve për të krijuar shtetin e tyre.

Kuvendet që çuan drejt mëvetësisë

Më 15 korrik 1911, Çerçiz Topulli me Aleks Koçin e Myftarin, pas një takimi kokë më kokë me Ismail Qemalin, nga Stambolli vjen në Korçë për të forcuar “Komitetin e Korçës” dhe për të vepruar me çetën e tij në Gjirokastër. Më 21 korrik, në Korçë erdhi një ushtri e madhe osmane që deklaroi shtet-rrethimin. Komanda osmane goditi Komitetin dhe burgosi 26 patriotë shqiptarë, ndër ta Themistokli Gërmenji e Dervish Hadëri. Çetat e Qamil Panaritit dhe Spiro Ballkamenit u bashkuan në Frashër dhe iu afruan Korçës gjysmë ore larg, me qëllim që t’i binin burgut. Por gjatë natës u rrethuan nga ushtria osmane dhe në përpjekje për të dalë nga rrethimi u vranë Kristaq M. Furxhi, Nuçi Lapi, Pajazit Rehova, Kostaq Spiro Kosturi, Odhisea N. Kota e Tushi Krastafillaqi.

Por, lajmi i botuar në gazetën ditore, që Fan Noli nuk do të vinte në Korçë, por ishte nisur për të vizituar kolonitë shqiptare në Sofje e Bukuresht e trishtoi edhe më shumë. Për ta takuar at Nolin, Nikolla në fund të nëntorit mbërriti në Bullgari. Në dhjetor të vitit 1911, në Sofje të Bullgarisë, me kërkesën e pareshtur të patriotëve shqiptar dhe besimtarëve ortodoksë shqiptar, vjen nga Bostoni i Amerikës, prifti i shquar dhe atdhetari i madh i çështjes shqiptare Fan S. Noli, me të cilin Nikolla pati fatin të takohet. Në muajin maj të vitit 1912, Kol Kota largohet nga Sofja dhe kthehet në atdhe në qytetin e Korçës. Me të shkelur në Shqipëri, përndiqet nga otomanët dhe strehohet në Voskopojë dhe më pas në

krahinën e Kolonjës.

Në qeverinë e parë shqiptare të kryesuar nga Ismail Qemali, Kostaq Kota djali i vëllait të Nikollës, u emërua kryesekretar i ministrisë së Arsimit. Për sigurimin e përfaqësuesve të mbledhur në Vlorë, vepronte çeta e komanduar nga Çerçiz Topulli, që kontrollonte territoret nga Vlora deri në Korçë. Deri në mbërritjen e Vidit, në periudhën janar-prill 1914, “Shteti Shqiptar” u qeveris nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Kjo periudhë qeverisje, “as mish as peshk”, u shfrytëzua nga nacionalistët grekë për realizimin e qëllimeve të tyre aneksioniste. Si pasojë, një numër i madh i forcave greke që erdhën nga Janina, pushtuan Korçën dhe Kolonjën, duke arrestuar mbi 60 atdhetarë dhe luftëtarë të lirisë, të cilët i burgosën në burgjet e Follorinës e Selanikut. Luftime të ashpra u bënë kudo, në Mesin e Urave, në Postenan, në grykat e Barmashit, në Bader, Ersekë, Borovë, Psar, Starje, etj., ku u vranë u masakruan e uplagosën mjaft luftëtarë, Mersin Prodani dhe Qani bej Ypi e shumë të tjerë si Vasil Kita, Vasil Trebicka, Paro Kita, Haki Glina, Riza Bej Helmësi, Nikoll (Kol) Kota e të tjerë. Pas kësaj masakre, Nikoll Kota kthehet në Korçë dhe regjistrohet “Vetëdashës” për mbrojtjen e qytetit. Konferenca e Ambasadorëve e mbajtur në Londër, kishte vendosur që Korça dhe krahinat e saj t’i mbeteshin Shqipërisë dhe ushtria greke të tërhiqej. Por Korça ishte e mbushur me një numër të madh ushtarakësh grekë të shpallur “të sëmure e të çmobilizuar”, por që ishin të armatosur. Veç tyre, ishte mbushur me andartë grekë dhe me grekomanë. Brenda qytetit qarkullonin policët vendor të komanduar nga Themistokli Gërmenji. Në përbërje të komandës së lartë të “xhandarmërisë vendore” ishte Nasi Kota, djali i Nikollës dhe vëllai i Odhisesë, dëshmorit të Luftës në “Orman Çiflik”.

Më 2 prill 1914, grekomanët dhe andartët grekë, të diktuar nga Themistokli Gërmenji që kryente detyrën e Kryekomisarit të Policisë, shpërthyen një kryengritje brenda qytetit duke shkëmbyer zjarr për gjithë natën me banorët, kombëtarët dhe vetëdashësit korçar. Në mëngjes, një shumicë e madhe e armatosur grekomanësh, mblihdhet në Mitropoli për të proklamuar bashkimin me Greqinë. Zëvendës prefekti Abdyl Ypi, bashkë me Themistoklinë i këshillojnë me ertësi po më kot. Lufta vazhdoi midis kryengritësve (grekoman) dhe xhandarmërisë (shqiptare), e cila u forcua përveç kombëtarëve të Korçës edhe me vetëdashësit që vrapuan nga fshatrat. Sipas kujtimeve të Mihal Gramenos, veteranëve të asaj lufte dhe shtypit të kohës, “Lufta mbajti tri ditë e tri net, duke u vrarë mjaft njerëz, midis të cilëve Vasil Trebicka, Riza bej Bllishti, Nikoll (Kol) Kota, Xhemaliu, e të tjerë, që kryenin detyrën e “vetëdashësit” për mbrojtjen e Korçës nga kryengritësit grekoman”. Nikoll (Kola) Kota, u kthye në simbol heroizmi e vetëmohimi për pasardhësit e tij, në mbrojtje të çështjes shqiptare dhe të ruajtjes së pavarësisë së Shqipërisë.

Teleskopi hapësinor "Webb" drejt hapësirës

Nisja e teleskopit hapësinor "Webb" i destinuar për të mbledhur "trashëgiminë" e teleskopit më të famshëm të hapësirës, "Hubble", është planifikuar për më 18 dhjetor, njoftoi në një deklaratë për shtyp "Arianespace", kompania që menaxhon nisjet nga baza evropiane e Kourous (Guajana Franceze).

I lindur nga bashkëpunimi midis NASA-s, Agjencisë Evropiane të Hapësirës (ESA) dhe agjencisë kanadeze të hapësirës CSA, "Webb" do të jetë teleskopi hapësinor më i madh dhe më i fuqishëm i lëshuar ndonjëherë.

Për të çuar pasardhësin e "Hubble" në orbitë do të përdoret një lëshues evropian "Ariane 5", i treti për vitin 2021. *ATSH-ANSA*



SpaceX i Elon Musk shtyn dërgimin e civilëve në hapësirë

NGA: OLIVER SERANI

FLORIDA– Elon Musk do të bëhet miliardi i fundit që do të mbikëqyrë nisjen e civilëve në hapësirë, të caktuar për më vonë gjatë javës, por me disa dallime të mëdha nga paraardhësit e tij Richard Branson dhe Jeff Bezos.

SpaceX i Musk njoftoi një vonesë 24-orëshe të lëshimit nga planet e tij fillestare, tani e caktuar për ngritje nga Cape Canaveral, Florida.

Ndryshe nga ekskursionet e

shkurtra në hapësirë nga Branson dhe Bezos me ekipazhet e tyre përkatëse civile verën e kaluar, vetë Musk nuk do të jetë në bordin e kapsulës Crew Dragon që do të hidhet në hapësirë në majë të raketës Falcon 9 të kompanisë.


Katër astronautët civilë në bord do të kalojnë tri ditë në hapësirë para se të bien në Oqeanin Atlantik. Në lançimin e Branson dhe Bezos, të dy fluturimet bënë udhëtime të shkurtra në hapësirë para se të zbrisnin përsëri në tokë.

Por katër fluturuesit civilë në mis-

ionin SpaceX, të quajtur "Inspiration4", do të përfshijnë miliarderin Jared Isaacman, i cili është themeluesi dhe CEO i Shift4 Payments dhe gjithashtu një pilot avioni i suksesshëm. Isaacman pagoi një shumë të panjohur parash për të bërë udhëtimin.

Pjesë e misionit gjithashtu është Hayley Arceneaux, një e mbijetuar nga kanceri i kockave e cila më vonë punoi për Spitalin Kërkimor të Fëmijëve St. Jude për pacientët me kancer, të cilës i përkushtohet misioni.

ZBULIMI



"Perseverance" merr me sukses një mostër të dytë nga shkëmbinjtë marsianë

Sonda hapësinore "Perseverance" e NASA-s mori me sukses një mostër të dytë nga shkëmbinjtë marsianë dhe kreu një analizë fillestare të saj, deklaroi agjencia hapësinore amerikane.

"Mostrat ka të ngjarë të jenë vullkanike me nuanca kripërash që mund të përmbajnë fluska uji", -shkroi NASA në Twitter.

Shkencëtari i projektit, Ken Farley tha se mostrat zbulojnë një mjedis potencialisht të banueshëm të qëndrueshëm.

"Është një zbulim i madh që uji ka qenë atje për një kohë të gjatë", -tha Farley në një deklaratë.

"Preservance" mbledhi me sukses mostrën e saj të parë të shkëmbinjve marsianë, të quajtur "Montdenier", të hënën, dhe e vendosi atë në mënyrë të sigurt në një enë për t'u kthyer në Tokë, ndërsa mostra e dytë, "Montagnac", u mbledh nga i njëjti shkëmb dy ditë më vonë.

"Preservance" zbarkoi në Mars në fund të shkurtit, pas një programi zhvillimor tetëvjeçar që kushtoi afërsisht 2,5 miliardë dollarë. *ATSH-ANSA*





VAJZAT SHQIPTARE, HISTORI SUKSESI

Hatixhe Çollaku, komandatja e parë e Inteligjencës së Gardës Kombëtare të "New Jersey" në Shqipëri



Unë quhem Hatixhe Çollaku, jam me prejardhje nga Shqipëria dhe jam oficer-togere në ushtrinë amerikane.

TOGERE E PARË
HATIXHE ÇOLLAKU